



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA BILISHT

TEL & FAX: 0811 238 15

Bilisht, më 24.01.2014

RELACION

MBI BUXHETIN E BASHKISË BILISHT PËR VITIN 2014

Hartimi dhe zbatimi i buxhetit vendor bazohet në dispozitat e ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Qeverisjes Vendore”; të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”; të ligjit nr.185/2013, datë 28.12.2013 “Për Buxhetin e Vitit 2014”; të V.K.M nr. 586, datë 17.07.2013 “Për klasifikimin e funksioneve dhe grupimin e njësive të qeverisjes vendore për efekt page të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore”; të VKM nr.864, datë 23.07.2010 “Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridike, publikë” si dhe akte të tjera nënligjore të nxjerra në zbatim të tyre.

I. TRANSFERTA E PAKUSHTËZUAR NGA PUSHTETI QENDROR

Transferta e pakushtëzuar (granti) shpërndahet në njësitë e qeverisjes vendore bazuar në një formulë e cila garanton objektivitet, transparencë dhe proporcionalitet ndërmjet njësive të qeverisjes vendore. Për vitin buxhetor 2014 transferta e pakushtëzuar pasqyrohet me rritje krahasuar me vitin 2013 për shumën 2.322.478 lekë. Në bazë të ligjit nr.185/2013, datë 28.12.2013 “Për Buxhetin e Vitit 2014” neni 15, për bashkitë deri në 20.000 banorë 25% e transfertës së pakushtëzuar do të përdoret për koston e personelit, që do të thotë se kjo përqindje do të përdoret për paga dhe sigurime shoqërore dhe pjesa tjetër për shpenzime dhe investime.

Transfertë e pakushtëzuar A:

31.349.723 Lekë.

II. TË ARDHURAT E TRASHËGUARA NGA VITI 2013:

Në buxhetin e vitit 2014 do të përfshihen të ardhurat e krijuara dhe të papërdorura nga viti 2013. Këto të ardhura parashikohen të jenë **7.296.869** lekë që do të zenë 10% të shpenzimeve të këtij buxheti.

III. TË ARDHURAT VENDORE TË VITIT 2014 :

Këto të ardhura parashikohen të realizohen në shumën **33.609.000** lekë të cilat do të mbulojnë 46.5% të shpenzimeve në total dhe është planifikuar që do të mbulojnë pjesën më të madhe të pagave dhe sigurimeve shoqërore. Shtjellimi i planifikimit të të ardhurave do të trajtohet nga zyra e tatim-taksave.

IV. STRUKTURA

Në bazë të ligjit Nr.8652, dt.31.07.2000 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Qeverisjes Vendore”, neni 32, pika a dhe ç dhe në bazë të V.K.M nr. 586, datë 17.07.2013 “Për Klasifikimin e Funksioneve dhe Grupimin e Njësive të Qeverisjes Vendore për efekt page të punonjësve të organeve të Qeverisjes Vendore”, Këshillit të Bashkisë i propozojmë strukturën organizative sipas projekt vendimit përkatës.

Nr	Emërtimi	Gjith.	Pergj.	Pergj.	Spec.i nivelit	Spec.i nivelit	Punonjes
			Sektori	Zyre	Te larte	Te mesem	
ADMINISTRATA							
1	Kryetar Bashkie	1					
2	Nënkryetare	1					
3	Sekretar i këshillit	1					
4	Sekretare,arshiviste,mardh.me publikun	1				1	
5	Zyra e financës	3	1			1	1
6	Zyra e shërbimeve	3	1				2
7	Zyra juridike, përgjegj.personeli	1			1		
8	Zyra e urbanistikës	2		1			1
9	Auditues i brendshëm	1			1		
10	Zyra e taksave	3	1			1	1
11	Admin.i mbroj.së tokës,transportit	1			1		
12	Inspektoriati ndërtimor	2		1		1	
13	Admin.e ndihmës ekonomike	1					1
14	Magaziniere,arkëtare	1					1
15	Policia bashkiake	2					
16	Shofer i administratës	1					1
17	Pastruese	1					1
	SHUMA	26	3	2	3	4	9
INSTITUCIONET NË VARËSI TË BASHKISË							
1	Qendra kulturore dhe biblioteka	1					1
2	Çerdhja e fëmijëve	5				1	4
3	Mirëmbajtje kanalizime	6					6
4	Punonjës sporti	2				1	1
5	Mirëmbajtje lulishte	14					14
	SHUMA	28	0	0	0	2	26
	TOTALI	54	3	2	3	6	35

Përllogaritja e pagave bëhet në bazë të shumës mujore të pagave shumëzuar me 12 muajt përkatës. Shtesa për paga është llogaritur rreth 2% të cilat do të përdoren për ndihma të menjëhershme nga Fondi i Vecante. Shtesa tjetër është pagesa që bëhet për festat të cilat bien në ditët e pushimeve në bazë të VKM nr.54, datë 03.02.2011 “Për kohëzgjatjen e punës dhe pushimit në institucionet shtetërore” si dhe llogaritja e fondit të veçantë jo më shumë se 10.000 lekë në vit për çdo punonjës në bazë të VKM nr.838, datë 21.10.2010 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të vecantë.” Në total fondit i shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore për vitin 2014 kap shumën 26.768.000 lekë. Planifikimi i sigurimeve shoqërore është bërë duke aplikuar koeficientin 16.7 % të nivelit të pagës. Për këtë vit është llogaritur dhe mbyllja e një pozicioni pune në mirëmbajtje kanalizime e cila do të hyjë në fuqi nga muaji shkurt 2014 me largimin e një punonjësi. Duke parë se shërbimi publik për pastrimin e qytetit dhe mirëmbajtjen e varrezave do të kalojë në administrimin e bashkisë, për këtë vit do të shtohen 12 punonjës nga të cilët 1 përgjegjës për shërbimin, një shofer për transportin e mbetjeve dhe 10 punëtorë për pastrim. Në total për këtë vit llogariten 54 punonjës dhe, pas muajit shkurt, me shkurtimin e një vendi pune do të reduktohet në

53 punonjës. Në bazë të nivelit të pagave, sipas tabelës së mëposhtme, është përlllogaritur llogaritur dhe fondi i pagave.

• **PAGAT E PUNONJËSVE DHE INSTITUCIONEVE NË VARËSI TË SAJ.**

Nr	Emërtimi	Nr i punonj.	Kategoria	Paga bazë	Vjetërsi	Pozicioni	Paga
ADMINISTRATA							
1	Kryetar i Bashkisë	1				79.500	79.500
2	Nënkryetar	1				70.500	70.500
3	Sekretar këshilli	1	I-B	14.000	2%	35.900	49.900
4	Përgjegjës sektori	3	III-B	14.000	2%	29.400	43.400
5	Përgjegjës zyre	2	III-B	14.000	2%	29.400	43.400
6	Specialist i niv.të lartë	3	III-B	14.000	2%	29.400	43.400
7	Specialist i mesëm	4	IV-A	14.000	2%	27.900	41.900
8	Punonjës administrate	7					34.000
9	Inspek. policisë bashkiake	1					42.000
10	Punonj.i policisë bashkiake	1					40.000
11	Punëtor administrate	1					29.000
12	Pastruese	1					29.000
Gjithsej		26					
INSTITUCIONET NË VARËSI TË BASHKISË							
1	Instrument & përgj.bibliot.	1					31.000
2	Spec. në fushën e sportit	1		14.000	2%	27.900	41.900
3	Punëtor fushe	1					29.000
4	Përgjegjës çerdheje	1					30.000
5	Edukatore çerdheje	4					29.000
6	Punonjës KUZ	1					31.000
7	Punonjës mirëmbajtjeje	5					29.000
8	Punonjës lulishteje	2					29.000
9	Përgjegjës pastrimi	1					30.000
10	Shofer pastrimi	1					29.000
11	Punt.pastrimi & roje varreza	10					22.000
Gjithesej		28					
TOTALI		54					

• **Fondi total i pagave i ndarë sipas institucioneve që bashkia mbulon.**

NR	EMËRTIMI	Numri i punonjësve	SHUMA
A	<u>ADMINISTRATA</u>	26	16.531.000
1.	Paga		14.202.000
2.	Sigurime shoqërore		2.329.000
B	<u>KULTURA & BIBLIOTEKA</u>	1	468.000
1.	Paga		402.000
2.	Sigurime shoqërore		66.000
C.	<u>KANALIZIME</u>	6	2.290.000
1.	Paga		1.969.000
2.	Sigurime shoqërore		321.000
D.	<u>SHËRBYME PUBLIKE</u>	14	4.307.000

1.	Paga		3.709.000
2.	Sigurime shoqërore		598.000
E.	<u>CERDHJA</u>	5	2.165.000
1.	Paga		1.862.000
2.	Sigurime shoqërore		303.000
F.	<u>SPORTI</u>	2	1.007.000
1.	Paga		865.000
2.	Sigurime shoqërore		142.000
	Shuma totale	54	26.768.000

1. SHPENZIMET PËR FUNKSIONET E VETA ADMINISTRATIVE

Në krahun e shpenzimeve është mirëparë një alokim sa më eficient i fondeve në dispozicion, duke pasur si objektiv maksimizimin e impaktit që ka buxheti lokal në jetën e qytetit.

1. ADMINISTRATA

	MALLRA DHE SHËRBIME	Fakt 2013	Detyrime 2013	Plan 2014
6020	Materiale zyre dhe të përgjithshme	525.873	0	427.000
6020100	Kancelari	244.773	0	150.000
6020300	Tonera	150.000	0	217.000
6020500	Blerje dokumentacioni	131.100	0	60.000
6022	Shërbime nga të tretë	706.937	316.539	1.187.500
6022001	Energji	193.258	20.868	220.000
6022002	Ujë	25.440	65.340	100.000
6022003	Telefon dhe internet (shp.për 14 karta/muaj për drejtuesin + detyrimet e 2013)	454.853	199.831	737.000
6022004	Posta dhe abonime	33.386	10.500	60.500
6022099	Formatime & instalime	0	0	50.000
6022099	Vendime gjyqësore	0	20.000	20.000
6021	Materiale të tjera	0	0	1.142.000
6021099	Uniforma policie	0	0	80.000

602	Projekt I IPA-s (7.609 Euro* 139.53 kursi i këmbimit janar 2013)	<u>0</u>	<u>0</u>	<u>1.062.000</u>
6023	Shpenzime transporti	798.137	9.900	750 . 000
6023100	Karburant për vitin 2014	699.837	0	700.000
6023200	Pjesë këmbimi, goma dhe bateri	98.300	9.900	50.000
6024	Shpenzime udhëtimi	150.000	64.720	214 .720
6024100	Shpenzime, dieta	150.000	64.720	214.720
6028	Shpenzime për kuota që rrjedhin nga detyrimet	497.104	525.000	827 . 000
6028100	KRMW (2013+2014)	497.104	525.000	827.000
6029	Shpenzime të tjera operative	1.619.835	0	1.684.000
6029006	Shpërblimi i këshilltarëve 12 mbledhje	1.619.835	0	1.684.000
	INVESTIME	<u>2.322.325</u>	<u>0</u>	<u>711.631</u>
231	Garanci difekti 5% ndërtim i sis.të ngrohjes së godinës së Bashkisë	2.322.325	0	121.091
231	Kolaudim i sis.të ngrohjes së godinës së Bashkisë	0	0	5.880
231	Personal kompjuter (PC) (2 copë)	0	0	120.000
231	Printera zyre (3 copë)	0	0	54.000
231	Tavolina (9 copë), Karrige (10 copë), Dritare (9 copë), Skrivani (1copë)	<u>0</u>	<u>0</u>	410.660
	SHUMA TOTALE E SHPENZIMEVE ADMINISTRATIVE	<u>6.620.211</u>	<u>916.159</u>	<u>6.943.851</u>

Të gjitha shpenzimet janë planifikuar në bazë të shpenzimeve faktike të vitit 2013; këtu futen blerjet për kancelari, tonera, dokumenta, pjesë këmbimi, dieta, karburant, etj. Gjithashtu në këtë mënyrë kemi llogaritur edhe shpenzimet për ujë, energji, telefon dhe shërbimet postare. Planifikimi për karta telefoni është bërë në bazë të VKM nr. 864, datë 23.07.2010 “Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridike, publikë”, pika 11 ku thuhet “...drejtuesit e organeve të pushtetit kanë të drejtë të pajisen me numër telefoni ... dhe shpenzimet për këtë shërbim në nivel vjetor të jenë në çdo rast jo më shumë se 2% e totalit të shpenzimeve për mallra dhe shërbime të miratuara për çdo institucion në buxhetin vjetor përkatës. Shpenzimet për kuota janë kontribute që bashkia i detyrohet të derdhë si anëtare aksionere me 4.72 % të aksioneve pranë shoqërisë KRMW Sh.a (Administrimi i Mbetjeve të Qarkut Korçë). Për vitin 2013 bashkia ka si detyrim të derdhë 525.000 lekë në bazë të buxhetit të miratuar për vitin 2013 të shoqërisë, ndërsa për vitin 2014 ky kontribut është në vlerë 302.000 lekë. Në total kjo shumë si kontribut nga ana jonë është 827.000 lekë. Shpenzime të tjera janë planifikuar në bazë të kërkesave të disa zyrave në bazë të funksioneve që kryejnë. Për këtë vit janë planifikuar një sërë investimesh si në paisje kompjuterike dhe orendi zyre. Po ashtu është planifikuar dhe pjesa që duhet të përballojë bashkia në përputhje me kontratën për projektin ndërkufitar të IPA-s midis Bashkisë Bilisht dhe Komunës së Bërvenicës në Maqedoni. Shuma prej 7.609 euro do të përdoret në përputhje me buxhetin e miratuar në këtë projekt.

2. KULTURA

Në zërin e kulturës janë planifikuar aktivitetet si më poshtë:

	AKTIVITETE KULTURORE	Fakt 2013	Detyrime 2013	Plan 2014
1	Aktivitet me rastin e 7 dhe 8 Marsit	0	0	100.000
2	Festa e romëve	60.000	60.000	110.000
3	Koncert për mbrëmjen e maturës	127.750	0	150.000
4	Festa e Çlirimit	0	0	50.000
5	Dhurata për Vitin e Ri 2015	146.666	0	150.000
6	Zbukurime qyteti për Vitin e Ri 2015	0	204.000	604.000
7	Fishekzjarre	30.000	0	30.000
8	Kontribut për fëmijët jetime	0	0	30.000
9	Kartolina urimi	0	12.000	29.000
10	Libra të rinj	0	0	100.000
	Shuma	334.416	276.000	1.353.000
602	Energji + telefon + ujë	101.795	1.247	120.000
	TOTALI	436.211	277.247	1.473.000

Me rastin e festive të 7-8 Marsit bashkia ka organizuar për tre vite me radhë mbrëmje me gratë e qytetit pa dallim feje, përkatësie politike, etj. Ky organizim ka pasur një shtrirje të gjerë dhe sot mendojmë që ky aktivitet është kthyer në traditë për qytetin tonë. Aktivitet tjetër organizohet dhe për festën e romëve në të cilën marrin pjesë dhe përfaqësues nga bashkia. Të dyja këto aktivitete kanë organizim të veçantë në bazë të natyrës së festës dhe bashkia jep kontributin e saj për zhvillimin e tyre. Në fillim të muajit korrik organizohet festa për mbrëmjen e maturës shtetërore. Nga ana jonë, si çdo vit, është planifikuar një fond për pagesën e një këngëtareje të ftuar si dhe ngritjen e një skene në qendër të qytetit. Ky aktivitet është bërë traditë prej disa vitesh dhe mendohet që të ketë vazhdimësi edhe më tej. Festat e fundvitit përbëjnë një angazhim nga ana jonë pasi fillojnë me zbukurimin e qytetit ku futen blerja e zbukurimeve të bredhit në qendër të qytetit apo riparime të ndriçuesve rrugorë. Organizimi i festës për fëmijët e dalluar të shkollave fillore, 9-vjeçare dhe kopshtit si dhe dhuratat e vitit të ri për fëmijët e çerdhes, kanë një zë në buxhetin e këtij viti për shumën 150.000 lekë. Po gjithashtu është planifikuar një fond nisur dhe nga kërkesat e institucioneve shkollore për pasurimin e bibliotekave me tituj të rinj.

3. SPORTI

Në planin e sportit pjesën më të madhe të shpenzimeve e zënë shpenzimet e udhëtimit. Për llogaritjen e tyre është marrë parasysh kalendari i ndeshjeve që do të zhvillohet jashtë qytetit nga ekipi i të rriturve por dhe dy ndeshje miqësore. Gjithashtu nga ana jonë janë planifikuar dhe shpenzime të tjera si blerja e uniformave për marrjen pjesë në kampionat, shpenzime për materiale dhe mirëmbajtje për fushën e sportit, si dhe asistencë mjekësore si detyrim i kontratës së lidhur midis bashkisë dhe mjekut, etj.

Llogaria Ekonomike	MALLRA DHE SHËRBIME	Fakt 2013	Detyrime 2013	Plan 2014
	SHUMA	1.190.400	8.000	1.465.200
6024100	Shpenzime udhëtimi (10 ndeshje për kampionat + 2 miqësore)	1.190.400	0	1.435.200
6024100	Asistencë mjekësore	0	8.000	30.000
6021099	MATERIALE	10.000	0	78.060
B.	Pleh	0	0	6.500
C.	Karburant	0	0	45.000
D.	Rrip makine	0	0	16.560
E.	Medikamente	10.000	0	10.000
ËËËË	UNIFORMA & MATERIALE SPORTIVE	458.000	0	297.720
A.	Uniforma tuta (25 palë)	0	0	75.600
B.	Uniforma futbollit (50 palë)	0	0	86.400
C.	Çanta përfaqësimi (25 copë)	0	0	57.600
D.	Topa (20 stërviçje+ 4 topa kampionati)	0	0	69.120
E.	Rrjeta (2 copë)	0	0	9.000
	SHËRBIME TË TJERA	228.984	5.553	202.000
6022001	Energji	228.324	5493	180.000
6022002	Ujë	660	60	22.000
	TOTALI	1.887.384	13.553	2.042.980

4. MIRËMBAJTJE KANALIZIMESH

Në këtë zë janë planifikuar një sërë materialesh për mirëmbajtjen e kanalizimeve. Gjithashtu kemi planifikuar dhe sistemime kanalizimi të ujërave të zeza në qytet.

Llogaria ekonomike	MALLRA DHE SHËRBIME	Fakt 2013	Detyrime 2013	Plan 2014
6021099	MATERIALE	9.200	0	173.400
A.	Tube kanalizimi (150 ml)	0	0	108.000
B.	Çimento (10 kv)	0	0	13.200
C.	Granil (5 m3)	0	0	10.800
D.	Kazma (5 copë)	0	0	3.000
F.	Lopata (5 copë)	0	0	3.000
G.	Goma karroce (3 copë)	0	0	5.400
I.	Çizma (7 palë)	0	0	6.000
J.	Sopata (5 copë)	0	0	7.200
H.	Bishta të ndryshëm (10 copë)	0	0	2.400
K.	Doreza pune (20 copë)	0	0	4.800
G.	Rubineta (15 copë)	0	0	4.500
L.	Tube 30 ml	0	0	3.600
M.	Bërryla (10 copë)	0	0	600
N.	TA(10 copë)	0	0	900
231	INVESTIME	354.000	0	2.032.000
231	KUZ rruga “Pavarësia” & “Mic Sokoli”	354.000	0	480.000
231	KUZ rruga “Burimi i Çardhakut” & “Faik Meka”	0	0	480.000
231	KUZ rruga “Mehmet Mullaj”	0		772.000
230	Projekt KUZ	0	0	200.000
231	Pastrim kanali kullues	0	0	100.000
	TOTALI	363.200	0	2.205.400

5. ÇERDHJA

Planifikimi i shpenzimeve për çerdden është bërë për të mbuluar ushqimin që konsumohet gjatë gjithë vitit për mesatarisht 15-17 fëmijë në muaj nga 22 fëmijë të regjistruar gjatë vitit 2013. Gjithashtu është planifikuar një fond për blerjen e shtretërve të rinj me fondin prej 300.000 lekë.

Llogaria ekonomike	MALLRA DHE SHËRBIME	Fakt 2013	Detyrime 2013	Plan 2014
	SHPENZIME	589.647	210.079	928.800
6021004	Ushqime	337.500	81.300	561.300
6022001/2/3	Energji / ujë / telefon	176.327	128.779	329.000
6021099	Gaz për gatim	0	0	18.500
6021099	Materiale të tjera	75.820	0	20.000
	INVESTIME	0	0	300.000
231	Krevatë	0	0	300.000
	TOTALI	589.647	210.079	1.228.800

6. MIRËMBAJTJE RRUGE

Planifikimi në zërin e energjisë elektrike që zë pjesën më të madhe të shpenzimeve në këtë program është bërë mbi bazën e faturimeve gjatë vitetve të kaluara. Duke parë se gjatë 5 viteve të fundit njësitë e ndriçimeve rrugore janë rritur, është rritur dhe faturimi i energjisë elektrike. Për planin e këtij viti është bërë një përlllogaritje e tillë, për 8 muaj (nga muaji mars deri në shtator) është llogaritur një mesatare mujore prej 430.000 lekë harxhim energji elektrike, ndërsa për 4 muaj që i takon periudhës dimërore ku kohëzgjatja e ndriçimit është më e gjatë, është planifikuar një mesatare mujore 515.000 lekë. Në total ndriçimi rrugor arrin shifrën e planifikuar prej 5.500.000 lekë. Shpenzimet e tjera janë vendosur për mirëmbajtje të ndriçimit rrugor dhe mirëmbajtje të rrugëve në qytet gjatë dëmtimit të tyre. Për këtë vit do të kemi disa investime të cilat janë parë të domosdoshme për t'u planifikuar, si: riparimi i rrugëve të dëmtuara nga konstruksioni i ujësjellësit të ri i cili përfundoi vitin që kaloi.

Llogaria ekonomike	MALLRA DHE SHËRBIME	Fakt 2013	Detyrime 2013	Plan 2014
	SHPENZIMET	5.766.029	535.514	7.087.796
6022001	Energji elektrike	5.019.079	457.014	5.500.000
6020200	Materiale elektrike	715.600	78.500	831.500
6021099	Mirëmbajtje rruge	31.350	0	256.296
6021099	Vendosja e rruspës për makinën për pastrimin e dëborës	0	0	500.000

	INVESTIMET	0	0	4.626.000
231	Sinjalistika rrugore vertikale, horizontale, pengesa	0	0	369.000
231	Riparim i rrugëve të dëmtuara në drejtimin tërthor	0	0	3.857.000
230	Studim projektimi i sheshit kryesor & rrethotullimit të Mirasit	0	0	400.000
	TOTALI	5.766.029	535.514	11.713.796

7. ARSIMI

Në këtë program shpenzimet mbulojnë disa nga institucionet arsimore, si: kopshti, shkolla fillore, shkolla 9-vjeçare dhe shkolla e mesme. Në artikullin ‘blerje dru’ parashikohet një shumë fondi për blerjen me procedurë të hapur në shumën **2.000.000** lekë për përballimin e periudhës së dimrit me ngrohje. Kjo shumë është përlogaritur për blerjen e 600 m³ stere dru. Në artikullin ‘materiale pastrimi’ bëhet i mundur realizimi i blerjeve të materialeve që furnizojnë shkollat dhe institucionet e tjera për pastrimin e tyre. Po kështu është planifikuar dhe fondi prej **400.000** lekë për lyerjen e bashkisë dhe institucioneve në varësi të saj. Në total shpenzimet për institucionet arsimore kapin vlerën **4.516.000** lekë.

Llogaria ekonomike	MALLRA DHE SHËRBIME	Fakt 2013	Detyrime 2013	Plan 2014
	SHPENZIME	2.977.302	74.938	3.646.000
6022001/2/3	Energji + ujë + telefon	693.902	74.938	700.000
6020200	Dru zjarri	1.680.000	0	2.000.000
6020200	Materiale pastrimi	225.000	0	400.000
6021099	Bojëra për lyerje	346.000	0	400.000
6021099	Xhama	14.400	0	50.000
6020200	Materiale elektrike	0	0	30.000
6022099	Riparim i banjove të shkollave	0	0	18.000
6022099	Riparim dyer + dritare të shkollave	0	0	24.000
6022099	Riparim banga + tavolina	18.000	0	24.000
	INVESTIME	0	170.000	870.000
231	Pore	0	0	300.000
231	Dritare	0	170.000	570.000
	TOTALI	2.977.302	244.938	4.516.000

8. SHËRBIME PUBLIKE

Në këtë program është bërë një studim i mirëfilltë për materialet dhe shërbimet e nevojshme për të kaluar aktivitetin e pastrimit në varësi të bashkisë. Në këtë aktivitet është përfshirë edhe shërbimi i varrezave të cilën e kryente firma sipërmarrëse. Një fond tjetër është përlogaritur për likuidimin e firmës DU&KO e cila vazhdon aktivitetin e saj. Me të, nga ana jonë, është lidhur një kontratë në datën **18.10.2011** për peridhën deri në shpalljen e firmës fituese për kryerjen e pastrimit. Në datën **27.12.2013** po kjo firmë lidh kontratën e saj dyvjeçare prej së cilës i detyrohem shumën **1.430.352** lekë. Kjo kontratë aktualisht është e përfunduar. Deri në miratimin e buxhetit dhe fillimin e aktivitetit të pastrimit nga ana jonë me firmën DU&KO është lidhur një shtesë kontratë në datën **30.12.2013** e cila është parashikuar në shpenzimet e mëposhtme. Për këtë vit është menduar të kryhet krastitja e pemëve në shëtitoren e qytetit. Është përlogaritur një fond prej **600.000** lekë për krastitjen e 77 pemëve, prerjen dhe sistemimin e druve për djegie si dhe largimin e mbeturinave që do të krijohen. Një zë tjetër është zbatimi i një vendimi gjykate në lidhje me tregun i cili u kthye në gjendjen e tij fillestare. Po këtë vit janë parashikuar disa shpronësime duke rishikuar edhe një herë shumat që do të përfitojnë poseduesit. Më poshtë paraqiten të gjithë zërat e detajuar.

Llogaria ekonomike	MALLRA DHE SHËRBIME	Fakt 2013	Detyrime 2013	Plan 2014
6021099	Vegla pune	0	0	77.400
A.	Karroca dore (4 copë)	0	0	19.200
B.	Lopata (10 copë)	0	0	6.000
C.	Kazma (2 copë)	0	0	1.200
D.	Gjemba (5 copë)	0	0	3.000
F.	Fshesa plastike (10 copë)	0	0	6.000
G.	Fshesa purteke (50 copë)	0	0	12.000
I.	Çizma (10 copë)	0	0	7.200
J.	Pelerina shiu (10 copë)	0	0	18.000
H.	Doreza pune (20 palë)	0	0	4.800
6021099	Materiale për dezinfektimin e kazanëve	0	0	60.000
G.	Gëlqere (5.000 kg)	0	0	60.000
	Materiale për funksionimin e makinës së pastrimit	0	0	1.666.800
6023100	Karburant (7.800 litra/vit)	0	0	1.560.000
6023100	Vaj makine	0	0	9.600
6023100	Alkol	0	0	1200
6023200	Bateri	0	0	24.000

6023200	Goma (6 copë)	0	0	72.000
6021099	Shërbimi i varrezave	0	0	144.000
A.	Granil 12 m3	0	0	25.920
B.	Çimento 50 kv	0	0	79.200
C.	Hekur	0	0	38.880
6022009	Pastrimi nga firma DU&KO për periudhën e mbetur	0	0	5.157.125
	Pastrimi 2011 (kontrata 18.10.2011)	0	0	926.773
	Pastrimi tetor-dhjetor 2013 (kontrata 27.12.2013)	0	0	1.430.352
	Pastrimi 2014 (shtesë kontrate 30.12.2013)	0	0	2.800.000
6022002	Shërbime të tjera	0	300	1.232.000
6022002	Ujë	0	300	132.000
6022099	Prerja e pemëve (77 pemë)	0	0	600.000
6022099	Vendim gjykatë për tregun	0	0	500.000
	Materiale për gjelbërimin e qytetit	0	0	36.000
6021099	Farë bari	0	0	36.000
231	INVESTIME	1.872.806	0	1.562.867
A.	Garanci defekti, rrethim & zgjerim i varrezave	1.872.806	0	98.568
B.	Supervizim për objektin rrethim & zgjerim i varrezave	0	0	3.900
C.	Kolaudim për objektin rrethim & zgjerim i varrezave	0	0	2.399
D.	Pemë	0	0	180.000
E.	Blerje e makinës teknologjike	0	1.278.000	1.278.000
	SHPRONËSIME	0	0	2.949.850
A.	Shpronësim pusi (Sadi Uzhuri me nr.pasurie 1198)	0	0	100.000
B.	Shpronësim toke (Petrit Graca me nr.pasurie 1091/22)	0	0	1.404.900
C.	Shpronësim toke (Albert Nastimi nr.2/272,2/275,2/277)	0	0	657.850
D.	Shpronësim toke (Rruga "Iliria")	0	0	602.100
E.	Shpronësim toke (Hivzi Zyryku)	0	0	185.000
	TOTALI	1.872.806	300	12.886.042

9. SHËRBIME TË TJERA

Në zërin 'shërbime të tjera' kemi parashikuar kontributin financiar që bashkia jonë duhet të depozitojë në buxhetin e këshillit të qarkut. Masa e kontributit llogaritet 3.4% e të ardhurave të parashikuara.

Zë tjetër është parashikuar 'fondi i emergjencave civile' në masën 1% të të ardhurave i cili do të përdoret nga këshilli bashkiak për dhënien e ndihmave financiare të familjeve në vështirësi.

Dhe së fundi është llogaritur dhe fondi rezervë për përballimin e shpenzimeve të paparashikuara në buxhet.

Llogaria ekonomike	MALLRA DHE SHËRBIME	Fakt 2013	Detyrime 2013	Plan 2014
	SHERBIME TE TJERA			
A.	Kontributi për Këshillin e Qarkut 3.4%	641.246	0	1.143.000
B.	Fondi rezervë 3%	50.000	0	1.008.000
C.	Fondi i emergjencave civile	0	0	336.000
	TOTALI	691.246	0	2.487.000

Të nderuar zotërinj këshilltarë,

Ju ftojme të votoni buxhetini, buxhet i cili do të jetë në shërbim të qytetit dhe komunitetit tonë.

Faleminderit!

Hartoi:

Përgjegjëse e zyrës së financës

Aurela LICI

Kryetari i Bashkisë

Valter MIZA



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA BILISHT
Tel & Fax 0811 2288

Bilisht, më 24.01.2014

PROJEKT- VENDIM
Nr. __, datë __.01.2014
Për strukturën e Bashkisë

Bazuar në ligjin nr. 8652 datë 31.07.2000 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Qeverisjes Vendore”, neni 32, germa ç:

PROPOZOJ:

I. Të miratohet struktura e Bashkisë Bilisht për vitin 2014 si më poshtë:

Nr	Emërtimi	Gjith.	Përgj.	Përgj.	Spec.i nivelit	Spec.i nivelit	Punonjës
			Sektori	Zyre	të lartë	të mesëm	
ADMINISTRATA							
1	Kryetar bashkie	1					
2	Nënkryetare	1					
3	Sekretar i këshillit	1					
4	Sekretare, arshivist, mardh.me publikun	1				1	
5	Spektori i financës	3	1			1	1
6	Spektori i shërbimeve	3	1				2
7	Zyra juridike, përgjegj. personeli	1			1		
8	Zyra e urbanistikës	2		1			1
9	Auditues i brendshëm	1			1		
10	Spektori i taksave	3	1			1	1
11	Admin.i mbroj.së tokës, transportit	1			1		
12	Inspektoriati ndërtimor	2		1		1	
13	Admin.e ndihmës ekonomike	1					1
14	Magaziniere, arkëtare	1					1
15	Policia bashkiake	2					
16	Shofer i administratës	1					1
17	Pastruese	1					1
	SHUMA	26	3	2	3	4	9
INSTITUCIONET NË VARËSI TË BASHKISË							
1	Qendra kulturore dhe biblioteka	1					1
2	Çerdhja e fëmijëve	5				1	4
3	Mirëmbajtje kanalizime	6					6
4	Specialist për aktivitetet sportive	2				1	1
5	Mirëmbajtje lulishte	2					2
6	Shërbimi publik	12					12
	SHUMA	28	0	0	0	2	26
	TOTALI	54	3	2	3	6	35

- II. Efektet e zbatimit të këtij projekt vendimi fillojnë nga data 1 janar 2014
- III. Në zërin “Mirëmbajtje kanalizimi” në muajin shkurt 2014 shkurtohet vendi i punës për një punonjës kështu që struktura do të kalojë nga 54 punonjës në 53 punonjës.
- IV. Ngarkohet zyra e financës dhe zyra juridike për zbatimin e tij.

Përgjegjëse e sektorit të financës
Aurela LICI

Kryetari i Bashkisë
Valter MIZA



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA BILISHT
Tel & Fax 0811 2288

Bilisht, më 24.01.2014

PROJEKT-VENDIM

Nr. ___ datë __.01.2014

Për pagat e punonjësve të bashkisë

Bazuar në ligjin nr.8652,datë 31.07.2000 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Qeverisjes Vendore” neni 29 pika 2, dhe neni 32 gërma c; në V.K.M nr.586, datë 17.07.2013 “Për klasifikimin e funksioneve dhe grupimin e njësive të qeverisjes vendore për efekt page të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore”, në ligjin nr. 8549 datë 11.11.1999 “Për Statusin e Nëpunësit Civil”:

PROPOZJ:

I. Të miratohen pagat e punonjësve si më poshtë:

Nr	Emërtimi	Nr i punonj.	Kategoria	Paga bazë	Vjetërsi	Pozicioni	Paga
ADMINISTRATA							
1	Kryetar i bashkisë	1				79.500	79.500
2	Nënkryetar	1				70.500	70.500
3	Sekretar këshilli	1	I-B	14.000	2%	35.900	49.900
4	Përgjegjës sektori	3	III-B	14.000	2%	29.400	43.400
5	Përgjegjës zyre	2	III-B	14.000	2%	29.400	43.400
6	Specialist i niv.të lartë	3	III-B	14.000	2%	29.400	43.400
7	Specialist i mesëm	4	IV-A	14.000	2%	27.900	41.900
8	Punonjës administrate	7					34.000
9	Inspek. policisë bashkiake	1					42.000
10	Punonj.i policisë bashkiake	1					40.000
11	Punëtor administrate	1					29.000
12	Pastruese	1					29.000
Gjithsej		26					
INSTITUCIONET NË VARËSI TË BASHKISË							
1	Instrument & përgj.bibliot.	1					31.000
2	Spec. në fushën e sportit	1		14.000	2%	27.900	41.900
3	Punëtor fushe	1					29.000
4	Përgjegjës çerdheje	1					30.000
5	Edukatore çerdheje	4					29.000
6	Punonjës mirmbajtje KUZ	1					31.000
7	Punonjës mirëmbajtjeje KUZ	5					29.000
8	Punonjës lulishteje	2					29.000
9	Përgjegjës pastrimi	1					30.000
10	Shofer pastrimi	1					29.000
11	Punt.pastrimi & roje varreza	10					22.000
Gjithësej		28					
TOTALI		54					

- II.** Të miratojë shpërblimin e këshilltarëve në masën 10% të pagës së kryetarit të bashkisë.
- III.** Efektet financiare fillojnë nga data 1 janar 2014.
- IV.** Ngarkohet zyra e finances dhe zyra juridike për zbatimin e tij.

Përgjegjëse e sektorit të financës
Aurela LICI

Kryetari i Bashkisë
Valter MIZA



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA BILISHT
Tel & Fax 0811 2288

Bilisht, më 24.01.2014

PROJEKT-VENDIM

Nr. ___ datë __.01.2014

PER MIRATIMIN E BUXHETIT FAKTIK PËR VITIN 2013

Bazuar në ligjin nr. 8652 datë 31.07.2000 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Qeverisjes Vendore” neni 19, pika 5, dhe neni 32, gërma dh; në ligjin nr. 119/1012 datë 17.12.2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, në ligjin nr.9836, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”,

PROPOZOJ:

I. Të miratohet buxheti faktik për vitin 2013, së bashku me burimet e tij të financimit, si më poshtë:

TE ARDHURAT

A. Granti 2013	29.027. 522	lekë	
B. Të trashëguara	7.335.456	lekë	
C. Të ardhura 2013	23.758.684,94	lekë	
Shuma			60.121.662,94 lekë

SHPENZIMET

A. Paga & sigurime shoqërore	20.561.821	lekë	
B. Shpenzime operative	25.749.919	lekë	
C. Investime	4.757.276	lekë	
D. Projekte	360.000	lekë	
Shuma			51.429.016 lekë

Përgjegjëse e sektorit të financës
Aurela LICI

Kryetari i Bashkisë
Valter MIZA



REPUBLIKA E SHQIPERISE

BASHKIA BILISHT

Tel & Fax 0811 22288

Nr. _____ prot

Bilisht, më 24.01. 2014

PROJEKT-VENDIM

Nr. ___ datë __.01.2014

Për shpenzimet e telefonisë celulare

Bazuar në VKM nr.864, datë 23.07.2010 “Për paisjen me numër telefoni celular të personave juridikë” pika 11.

PROPOZOJ:

- I. Të miratojë shpenzime për telefoni celulare në masën 1% të shumës për mallra dhe shërbim në vlerën 168.000 lekë.
- II. Ngarkohet drejtorja zyra e financës për zbatimin e këtij vendimi.

Përgjegjëse e zyrës së financës
Aurela LICI

Kryetari i Bashkisë
Valter MIZA



REPUBLIKA E SHQIPERISE

BASHKIA BILISHT

Tel & Fax 0811 22288

Nr. _____ prot

Bilisht, më 24. 01. 2014

PROJEKT-VENDIM

Nr. ___ datë __.01.2014

Për normativën e harximit të karburantit

Bazuar në ligjin nr.8652, datë 31.07.2000 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Qeverisjes Vendore ” neni 4 pika a.

PROPOZOJ:

- I. Të miratojë limitin mujor të harximit të karburantit në masën 300 litra/muaj për mjetin me targë DV 1474 A me normë harxhimi 10 litra/100 km.
- II. Ngarkohet drejtoria zyra e financës për zbatimin e këtij vendimi.

Përgjegjëse e zyrës së financës
Aurela LICI

Kryetari i Bashkisë
Valter MIZA



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA BILISHT

Tel & Fax 0811 22288

Nr. _____ prot

Bilisht, më 24.01. 2014

PROJEKT-VENDIM

Nr. ___ datë __.01.2014

PER BUXHETIN E VITIT 2014

Bazuar në ligjin nr. 8652 datë 31.07.2000 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Qeverisjes Vendore” neni 19, pika 5, dhe neni 32, gërma dh: në ligjin nr. 185/2013 datë 28.12.2013 për “Buxhetin e vitit 2014”, në ligjin nr.9836, datë 26.06.2008 për “Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë,

PROPOZOJ:

1. Të miratohet buxheti i vitit 2014 me treguesit e mëposhtëm:

TE ARDHURAT

Të ardhurat e planifikuara 2014	33.609.000 lekë
Të trashëguara nga viti 2013	7.296.869 lekë
Granti i vitit 2014	31.349.723 lekë

SHUMA

72.255.592 leke

SHPENZIMET

Administrata Paga+Sig.Shoqërore	22.763.220 lekë
Kultura	1.941.000 lekë
Sporti	3.049.980 lekë
Ujësjetës- kanalizime	2.463.400 lekë
Çerdhja	3.093.800 lekë
Mirëmbajtje rrugë	7.087.519 lekë
Arsimi bazë	2.587.000 lekë
Arsimi i mesëm	1.059.000 lekë
Shërbime publike	12.680.325 lekë
Shërbime të tjera	2.478.000 lekë

SHUMA

59.203.244 lekë

INVESTIMET

Nga të ardhurat + Granti 13.052.348 lekë

SHUMA

13.052.348 lekë

Përgjegjëse e sektorit të financës

Kryetari i Bashkisë